

Data 21.07.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Sherbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Hapje Zhbllokim Pusetash”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Shërbime te zhbllokimit per struktura tuba

VLERA E FONDIT LIMIT: 19,999,475 (nentembehjete milion e nenteqind e nentedhjete e nente mije e katerqind e shtatedhjtete e pese) lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar autoriteti/enti kontraktor UKT sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3 përkatësisht në vlerën 399.989.5(treqind e nenedhjete e nente mije e nenteqind e tetedhjete e nente pike pese)*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”e ndryshuar

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.2 Kapaciteti ekonomik –financiar

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022 ku vlera e

xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% të fondit limit.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 1, pika 2, si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Per Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarinimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike".

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2020, 2021, 2022) të çertifikuara nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006”Për sistemin e taksave vendore”i ndryshuar; **(lidhur me afatet e kryerjes se pagesave te caktuara nga njesite e veteqeverisjes vendore për vitin 2023)**, në të cilën është regjistruar sipas QKB dhe vendimeve të Këshilleve Bashkiake të njësive vendore ku operatorët ushtrojnë aktivitetin.

(Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

2.2.4.Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2023 sipas ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me vetëdeklarimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2023 sipas prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 30 % të vlerës së fondit limit të kësaj kontrate përkatësisht jo më e vogël 5,999,842.5 (pese milion e e nenteqind e neneedhete e nente mije e teteqind e dyzet e dy presje pese) lekë pa tvsh.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
ose,

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77/4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufirit të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

- c) Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e lartë monetar. Vlera për furnizime të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvoja duke patur parasysh objektin dhe vlerën e fondit limit.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdosshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha shërbimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit stafi inxhinierik si më poshtë:

1 (një) Inxh.Hidroteknik

2.5.Një punësim mesatar i të paktën 10(dhjetë) personave për muajin e fundit.

a)Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin e fundit.

b) Listë pagesat e punonjësve të plotësuara rregullisht sipas formatit e përcaktimeve që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit.

2.6. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar minimumi 2(dy)shofer (brenda numrit të kërkuar në pikën 2.5 të DST-së.

Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, lejet e drejtimit të lëshuar për mjete teknologjike lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për muajin e fundit.kjo per rastin kur operatori ekonomik I ka pronesi mjetet.

Për rastin kur mjetet sigurohen nëpërmjet kontratës së qerasë atehere autoriteti kontraktor për punonjesit (shoferë),mund të paraqesi kontratë punësimi ose të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për muajin e fundit.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar duhet te dorezojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit **Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma b), gërma c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Referuar specifikimeve në dosjen e procedures dhe natyres se sherbimit është e domosdoshme që operatorët e mundshëm ekonomikë duhet të dëshmojnë fuqinë e kërkuar punëtore të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimi.

Per te realizuar hapjen dhe zhbllokimin e pusetave , sipas kerkesave te AK , duke patur parasysht shtrirjen e gjere qe ka rrjeti i ujesjelles kanalizimeve ne qytetin e Tiranës, eshte kerkuar ky numer punonjesish nga ana e AK , qe sherbimi te kryhet ne kohe dhe cilesine e duhur per qytetaret.

Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

2.7 . Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.

2 (dy)makina teknologjike pastrimi dhe transporti për mbetjet e pusetave të shiut me kovë vetngarkuese të mbyllur dhe vetëshkarkuese .

a)Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik; d) siguracion mjeti, (i vlefshëm);

- b) Për mjetet e deklaruara me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) çertifikaten e kontrollit teknik, d) siguracion mjeti (i vlefshëm).
- c) Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.
- d) Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.
- e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se disponon mjetet për të realizuar kontratën objekt prokurimi.
- f) Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

g) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

2.8. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.

2(dy) sonda teknologjike me presion 170-275 bar me kapacitet mbajtës të ujit 12-13 m³ me depozitë me ndarje të lëvizshme, Gjatësia e sondës 80 ml, me Ø 1 pol te pajisura me pompe presioni dhe vakumi.

2(dy) sonda të vogla me presion nga 100-150 bar (per tubacionet e zgarave të shiut me dimension 400 mm). Kapaciteti mbajtës i ujit 4-5 m³ me tub nga 1/2-3/4 pol.

Njëra nga sondat duhet të jetë e pajisur me pompë vakumi dhe presioni dhe tjetra me pompe vakumi.

Për sondat operatori ekonomik duhet të disponojë pajisjet/kokat e sondave si më poshtë vijon:

Diametri/pol	Litra/minut	dimensioni	Gjatesia e tubit	Pesha e sondes/koka
G1 ¼ ”	Ab350	800-4000	30x76	52 kg
G1 ¼ ”	Ab330	600-2500	25x58	30
G 1 ”	Ab300	500-1500	22x50	24
G1 ”	Ab200	250-800	20x40	21

G1 ¾ ”	Ab220	250-800	20x40	15
--------	-------	---------	-------	----

Diametri/pol	Litra/minut	dimensioni	Gjatesia e tubit	Pesha e sondes/koka
G1 ¼ ”	Ab400	600-1500	20x50	35 kg
G1 ¼ ”	Ab330	500-1000	16x42	28
G 1 ”	Ab250	300-800	14x35	20

Diametri/pol	Litra/minut	dimensioni	Gjatesia e tubit	Pesha e sondes/koka
G1 ¼ ”	Ab350	300-1000	12x20	10.5 kg
G1 ”	Ab300	250-800	11x18	8
G 1 ”	Ab250	200-500	10x15,5	5.5
G1 ¾ ”	Ab100	200-500	10x15,5	5.5

Për të dëshmuar disponimin e pajisjeve të kërkuara në pikën 10 në rast pronësie operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore/deklaratë zhdoganimi apo çdo lloj forme e parashikuar nga Kodi i Civil Republikës së Shqipërisë.

Kur mjetet janë me qera, duhet të paraqitet kontrata e qerasë me afat jo më të vogël se sa afati i kryerjes së shërbimit shoqëruar me dokumentat e mjeteve më faturë TVSH ose deklaratë zhdoganimi ose çdo lloj forme e parashikuar nga Kodi i Civil i Republikës së Shqipërisë.

Shënim: Për pikat 2.4, 2.5, 2.6, 2.7, 2.8 , më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.8.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, *përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit*, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të

dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Vendosja e llojit të mjeteve është përcaktuar në bazë të kritereve teknike të përgjithshme të ardhur nga Departamenti përkatës, pranë Drejtorisë së prokurimeve, bazuar gjithashtu në specifikimet teknike dhe natyrën e punës që do të realizohet për këtë procedurë prokurimi.

Mjetet e kërkuara janë të domosdoshme në momentet që zhbllokimi dhe pastrimi i pushtave nuk arrihet të bëhet manualisht si dhe UKT sh.a nuk disponon llojet e mjeteve të mesipërme për zhbllokimin dhe pastrimin e pushtave.

2.9..Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- a) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO zerave që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.
- b) Çertifikatën ISO 14001-2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO zerave që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencen/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizejnimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

14001:2015 specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit mjedisor që një organizatë mund të përdorë për të përmirësuar performancën e saj mjedisore. ISO 14001:2015 është menduar për përdorim nga një organizatë që kërkon të menaxhojë përgjegjësitë e saj mjedisore në një mënyrë sistematike që kontribuon në shtyllën mjedisore të qëndrueshmërisë. ISO 14001:2015 ndihmon një organizatë të arrijë rezultatet e synuara të sistemit të saj të menaxhimit mjedisor, të cilat ofrojnë vlerë për mjedisin, vetë organizatën dhe palët e interesuara.

ISO 14001:2015 është i zbatueshëm për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia, lloji dhe natyra, dhe zbatohet për aspektet mjedisore të aktiviteteve, produkteve dhe shërbimeve të saj që organizata përcakton se mund t'i kontrollojë ose ndikojë duke marrë parasysh perspektivën e ciklit jetësor.

Në të gjitha rastet kur përmendet certifikatë ,markë,emër i veçantë ,patentë,vizatim ose tip,origjine specifike,prodhues ose sipërmarrës pranohet edhe ekuivalent i tyre.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentin: Kriteret e vecanta të kualifikimit janë në përpjestim me kohezgjatjen, aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që do të prokurohet dhe i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për tu njohur me kapacitetet teknike, financiare, dhe profesionale të ofertuesve të mundshëm për realizimin me sukses të kontratës

Argumentim mbi specifikimet teknike:

- 1- Argumentimi I parametrave të mjeteve teknologjike për hapje dhe zhbllokim pusetash si më poshtë:
 - Pastrimi I kolektoreve duhet të bëhet në rrjetet kryesore të cilat janë në dimensione Ø800-Ø2000mm.
 - Thelletesite e pusetave variojnë 2-5m.
 - Sasise të materialeve që nxirren nga kolektori dhe bllokimeve të shpeshta që kanë. Shkalla e bllokimit të këtyre kolektoreve është e lartë dhe kërkohet që të bëhet njëkohësisht 2 procese (edhe sonde me presion edhe vakum për thithjen e ujërave të ndotur gjatë procesit).
 - Gjatesia e sondes varet nga largësia e pusetave të kolektorit kryesor (60-80m).
 - Volumet e pajisjeve duhet të jenë të tilla që të mbajnë ujë të pastër në seksion dhe të depozitojnë ujë të ndotur (ujra të zeza, ujra shiu, ujra të ndotur) në seksionin tjetër të depozites.

- Depozita duhet te jete me ndarje te levizhme per te bere procesin e plote sipas difektit qe mund te kerkohe. Pasi makineria teknologjike duhet te kryej dy procese: te mbaj uje me presion per sonden dhe te depozitoj ujra te ndotur me thithje.
 - Ne kerkojm garanci qe ne cdo moment firma te mos nderprese punen dhe te zbatoj me perpikmeri grafikun e pastrimit.
 - Parashikimi I situatave emergjente ne rrjetin e kanalizimeve.
 - Kolektoret me permasa 800-2000mm jane problematike dhe shkalla e veshtiresise eshte e larte.
- 2- - Ne rruget dytesore, ku nuk futen dot mjetet teknologjike te kolektoreve te medhenj (pika 1), duhen mjete te vogla te pershtatshme per rrugicat e blloqeve banimit. Keto mjete do te perdoren per tubacione Ø200mm – Ø600mm, ne te cilin sistemi I kanalizimit eshte miks, ujra shiu dhe ujra te zeza.
- Keto mjete bejne pastrim te rrjtit dytesor ne lagje, ne te cilin kemi kombinim me zgarat e shiut dhe kolektorit te ujrave te zeza.
 - Sasia e madhe e problematikave ne zone me rrjetin e kanalizimeve kerkon nje nderhyrje te vazhdueshme ne keto blloqe banimi.
 - Kapaciteti mbajtes percaktohet nga madhesia dhe parametrat teknik te mjetit teknologjik.

Njësia e prokurimit